

Kushtet klimatike të Amerikës

Amerika Veriore:



Për shkak të faktorëve klimatik siç janë gjerësia gjeografike, relievi, afërsia me detrat dhe oqeanet, në kontinentin e Amerikës Veriore paraqiten lloje të posaçme klimatike. Territoret të cilat kanë dalje në Oqeanin e Qetë dhe Atlantik, kryesisht pjesa e Amerikës së Mesme, karakterizohen me klimë të butë, subtropikale dhe detare.

Në brendësi të kontinentit karakteristike është klima e butë - kontinentale, pjesët më të larta të Kordiljereve spikaten me klimë tipike malore. Në hapësira të caktuara paraqitet klimë shkretinore. Të atilla janë pjesët e Teksasit, Arizonës dhe shkretëtirës Mohave (Nevada Jugore, Kalifornia juglindore).

Kërkoni në hartë këto vende ↑ dhe shënoni në cilën pjesë të kontinentit gjinden?

Pjesët më veriore të Amerikës Veriore karakterizohen me klimë polare, në të cilën zotëron çdoherë dimri.

Karakteristikë për klimën në Amerikën Veriore është paraqitja e tornadove, të cilat krijohen si shkak i ngrohjes intensive të ajrit dhe rrymave të larta të ajrit. Kështu, në formë vorbulle me një hapësirë prej qindra metrash me shpejtësi prej rreth 50km/ orë, duke mbartë me vete re stuhie, pluhur dhe duke shkatërruar gjithçka para saj. Tornadot janë më prezent në pjesën jugore dhe qendrore të SHBA-ve dhe Meksikës.

Amerika Jugore:



Për shkak se nëpër Amerikën Jugore kalon Ekuatori, pjesa më e madhe e kontinentit karakterizohet me klimë tropikale dhe subtropikale. Më saktësisht, në brezin ekuatorial gjenden territoret Amazonia, malet Guajane dhe pjesët veriore të Andeve, këtu është e pranishme klima ekuatoriale me temperatura të larta dhe lagështi e reshje të mëdha. Në jug të brezit ekuatorial shtrihen territoret me klimë tropikale dhe subtropikale. Ato përfshijnë pjesët e mesme të Andeve, ultësitrat përgjatë lumit Parana dhe malet e rrafshnaltat e Brazilit. Në jugun e shkajshëm, përkatësisht në Tokën e Zjarrtë janë të pranishme karakteristikat klimatike subpolare.

Mbi veçoritë klimatike të Amerikës Jugore ndikim të madh kanë masivet malore dhe rrymat detare. Kjo domethënë se, duke shkuar në lartësi më të mëdha mbidetare, klima prej asaj kontinentale ndryshon në klimë tipike malore.

Nga krahinat jugore, përgjatë brigjeve të Amerikës Jugore lëvizin rryma të ftohta detare, të cilat poashtu mundësojnë mot më të freskët. Në Amerikën e Jugut, klima shkretinore është tip i veçantë klimatik, që paraqitet në pjesët perëndimore, më saktë në pjesët veriore të shtetit të Kilit. E tillë është shkretëtira Atakama. Të gjindet shteti Kili në hartën gjeografike.

Përgjigju në pyetjet:

1. Çfarë lloj klime kemi në pjesën e Amerikës së Mesme?
2. Në cilat vende paraqitet klima shkretëtinore në Amerikën Veriore?
3. Çka janë tornadot?
4. Cilat territore gjinden në brezin ekuatorial?